

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Goal: ZVOGËLIMI I PABARAZIVE

Zvogëlimi i pabarazisë brenda çdo vendi dhe ndërmjet shteteve.

Target: Objektivi 10.7

10.7 Të lehtësohet migracioni dhe lëvizja e njerëzve e organizuar, e sigurt, e rregullt dhe e përgjegjshme, përfshirë edhe përmes zbatimit të politikave të planifikuara dhe të mirëmenaxhuara për migrimin

Instrumentet ndërkombëtare	Nenet
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas	Neni 6
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas	Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme, duke përfshirë legjislacionin, për luftimin e të gjitha formave të trafikut të grave dhe të shfrytëzimit të prostitucionit të grave.
Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor	Neni 5. b.
Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor	5. b. E drejta e sigurisë së personit dhe e mbrojtjes së tij nga shteti kundër dhunës dhe keqtrajtimit qoftë nga funksionarë të qeveritarë, qoftë nga ndonjë grup ose institucion i veçantë
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike	Article 6.1
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike	E drejta e jetës së shtë e drejtë e lindur e njeriut. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga jeta.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

Neni 9,1

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

1. Secili ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së personit të tij. Askush nuk duhet të jetë objekt i një arrestimi ose burgimi arbitrar. Askush nuk duhet të privohet nga liria, përveç për arsye dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj.

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

Neni 7

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës dhe as dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjërzore e poshtëruese. Në veçanti, askush nuk duhet t'i nënshtrohet një eksperimenti mjekësor ose shkencor pa pëlqimin e tij të lirë.

Neni 8

1. Askush nuk duhet të mbahet në robëri; robëria dhe tregtia me robër janë të ndaluara në të gjitha format e tyre:

2. Askush nuk duhet të mbahet në një gjendje nënshtrimi,

3. (a) Askush nuk duhet të shtrëngohet të kryejë punë të detyruar ose të detyrueshme;

(b) Paragrafi 3 (a) nuk duhet të interpretohet asisoj sikur ndalon vuajtjen e dënimit me punë të detyruar të dhënë nga një gjykatë kompetente, në ato vende ku disa krime ndëshkohen me burgim të shoqëruar me punë të detyruar;

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

(c) Në kuptim të këtij paragrafi, termi "punë e detyruar ose e detyrueshme" nuk konsiderohet:

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

(i) Çdo punë ose shërbim që nuk është përmendur në nënparagrafin (b), që kërkohet normalisht të kryhet nga një person i burgosur në bazë të një vendimi gjyqësor të rregullt ose nga një person i cili është liruar me kusht;

(ii) Çdo shërbim me karakter ushtarak dhe, në vendet ku njihet kundërshtimi i ndërgjegjes, çdo shërbim kombëtar që kërkohet në bazë të ligjit nga kundërshtuesit e ndërgjegjes;

(iii) Çdo shërbim që kërkohet në raste të jashtëzakonshme ose të fatkeqësive që rrezikojnë jetën ose mirëqenien e bashkësisë;

(iv) Çdo punë ose shërbim që bëjnë pjesë në detyrimet qytetare normale.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 4

1. Askush nuk do të mbahet në skllavëri ose në robëri.
2. Askush nuk do të shtrëngohet të kryejë punë me dhunë ose të detyruar.
3. Për qëllim të këtij neni, termi “punë e kryer me dhunë ose e detyruar”, nuk përfshin:
 - a) çdo lloj pune që i kërkohet të kryejë zakonisht një personi të ndaluar në kushtet e parashikuara nga neni 5 i kësaj Konvente ose gjatë liritimit të tij me kusht;
 - b) çdo lloj shërbimi të karakterit ushtarak ose, në rastin e kundërshtarëve të ndërgjegjes në vendet ku kundërshtimi i ndërgjegjes është i njohur me ligj, shërbimi që kryhet në vend të shërbimit ushtarak të detyrueshëm;
 - c) çdo lloj shërbimi që kërkohet në rast krizash ose fatkeqësish, që kërcënon jetën ose mirëqenien e komunitetit;
 - d) çdo lloj pune ose shërbimi që është pjesë e detyrimeve normale qytetare.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 3

Gjithkush ka të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e personalitetit.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 5

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet mundimit, veprimit ose dënimit të egër, jonjerëzor ose poshtërues.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 4

Asnjëri nuk duhet të mbahet si skllav ose çifçi; skllavëria dhe tregtia e skllavëve janë të ndaluara në të gjitha format.

Neni 6

Konventa për të Drejtat e Fëmijës Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Neni 6

1. Shtetet palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e lindur për të jetuar.
2. Shtetet palë marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 37

(a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepen për shkelje të ligjit të kryera nga persona nën 18 vjeç;

(b) Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për një kohë të përshtatshme sa më të shkurtër.

Konventa për të Drejtat
e Fëmijës
Konventa për të Drejtat
e Fëmijës

(c) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të lindur të njeriut dhe në mënyrën e cila merr parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në intresin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, përveç në rrethana të jashtëzakonshme;

(ç) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të sfidojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.

Neni 10 (2)

Konventa për të Drejtat
e Fëmijës
Konventa për të Drejtat
e Fëmijës

2. Një fëmijë, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale dhe takime të rregullta të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme. Për këtë qëllim dhe në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë, sipas paragrafit 1 të nenit 9, Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës dhe të prindërve të tij për t'u larguar nga çdo vend, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehen në vendin e tyre. E drejta për t'u larguar nga çdo vend bëhet objekt kufizimesh vetëm në rastet e përcaktuara me ligj, të cilat janë të nevojshme për të mbrojtur sigurimin kombëtar, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe që janë në pajtim me të drejtat e njohura në këtë Konventë.

Neni 33

Konventa për të Drejtat
e Fëmijës
Konventa për të Drejtat
e Fëmijës

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi ipaligjshëm i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, siç përcaktohen nëkonventat përkatëse ndërkombëtare dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të këtyre lëndëve.

Konventa për të Drejtat
e Fëmijës
Konventa për të Drejtat
e Fëmijës

Neni 34.b

b. Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme;

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Konventa për të Drejtat
e Fëmijës

Neni 34.c

Konventa për të Drejtat
e Fëmijës

c. Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Konventa për të Drejtat
e Fëmijës

Neni 35

Konventa për të Drejtat
e Fëmijës

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë.

Ligjet

Nenet

Nuk ka rezultat